

**SGS Automotive Albania sh.p.k.**

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe  
Pasqyrat Financiare më dhe për  
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

## PËRMBAJTJA

	Faqe
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA PËRMBLEDHËSE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	5
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	6 - 28

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Aksionarit dhe Drejtimit të SGS Automotive Albania sh.p.k.:

### *Raporti mbi Pasqyrat Financiare*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të SGS Automotive Albania sh.p.k. bashkëngjitur, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

### *Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

### *Përgjegjësia e Audituesit*

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethana të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

### *Opinionit*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të SGS Automotive Albania sh.p.k. më 31 dhjetor 2015 si dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

*Deloitte Audit Albania sh.p.k.*

25 maj 2016  
Tiranë, Shqipëri

*Nuriona Berdica (Sokolaj)*  
Partner Angazhimi



**SGS Automotive Albania sh.p.k.**  
**Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015**  
*(Shumat janë të shprehura në LEK)*

	Shënime	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
<b>Aktivët</b>			
<b>Aktivët afatgjatë</b>			
Aktivët afatgjatë jomateriale në proces	4	4,296,487	-
Aktivët afatgjatë jomateriale	4	509,253,456	563,908,342
<b>Totali i aktiveve afatgjatë</b>		<b>513,549,943</b>	<b>563,908,342</b>
<b>Aktivët afatshkurtra</b>			
Inventari	5	6,561,161	7,478,362
Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera	6	16,377,166	7,104,596
Paraja dhe ekuivalentet e saj	7	374,788,695	358,614,776
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>397,727,022</b>	<b>373,197,734</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>911,276,965</b>	<b>937,106,076</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksionar	8	190,000,100	190,000,100
Fitimi i paspërndarë		132,577,595	93,788,736
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>322,577,695</b>	<b>283,788,836</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrime afatgjatë</b>			
Divident për t'u paguar		89,099,299	-
Vlera e riinvestimit	11	171,604,400	139,302,800
<b>Totali i detyrimeve afatgjatë</b>		<b>260,703,699</b>	<b>139,302,800</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Huatë afatshkurtra	9	227,834,964	433,213,386
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	10	91,026,915	69,683,165
Tatim fitimi i pagueshëm		9,133,692	11,117,889
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>327,995,571</b>	<b>514,014,440</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>911,276,965</b>	<b>937,106,076</b>

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Drejtimi i Shoqërisë më 30 mars 2016 dhe firmosur nga:

Z. Alexandros Michuil  
 Administrator

Znj. Mirketa Punqi  
 Drejtore Finance



Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 deri në 28 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**SGS Automotive Albania sh.p.k.**

**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

*(Shumat janë të shprehura në LEK)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
<b>Të ardhurat operative</b>			
Të ardhurat	12	804,927,643	740,099,264
<b>Totali i të ardhurave operative</b>		<b>804,927,643</b>	<b>740,099,264</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Materiale të përdorura për konsum	13	(14,638,887)	(16,134,627)
Shpenzime personeli	14	(201,833,917)	(188,108,733)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4	(103,073,742)	(81,259,790)
Shpenzime të tjera operative	15	(298,799,387)	(301,456,108)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(618,345,933)</b>	<b>(586,959,258)</b>
<b>Fitimi nga aktiviteti operativ</b>		<b>186,581,710</b>	<b>153,140,006</b>
<b>Humbje financiare, neto</b>			
Të ardhura financiare		3,875,268	2,662,292
Shpenzime financiare		(12,653,519)	(28,695,009)
<b>Totali i humbjes financiare</b>	16	<b>(8,778,251)</b>	<b>(26,032,717)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>177,803,459</b>	<b>127,107,289</b>
Tatimi mbi fitimin	17	(45,225,864)	(33,318,553)
<b>Fitimi neto i vitit</b>		<b>132,577,595</b>	<b>93,788,736</b>
Të ardhura të tjera përmbledhëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin</b>		<b>132,577,595</b>	<b>93,788,736</b>

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 deri në 28 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**SGS Automotive Albania sh.p.k.****Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015***(Shumat janë të shprehura në LEK)*

	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>Fitimi i pashpërndarë</b>	<b>Totali</b>
<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>190,000,100</b>	<b>59,789,151</b>	<b>249,789,251</b>
Fitimi i vitit	-	93,788,736	<b>93,788,736</b>
Dividenti i paguar	-	(59,789,151)	<b>(59,789,151)</b>
Të ardhura të tjera përmbledhëse	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2014</b>	<b>190,000,100</b>	<b>93,788,736</b>	<b>283,788,836</b>
Fitimi i vitit	-	132,577,595	<b>132,577,595</b>
Dividenti i pagueshëm	-	(93,788,736)	<b>(93,788,736)</b>
Të ardhura të tjera përmbledhëse	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>190,000,100</b>	<b>132,577,595</b>	<b>322,577,695</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 deri në 28 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**SGS Automotive Albania sh.p.k.**

**Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

(Shumat janë të shprehura në LEK)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative:</b>		
Fitimi pas tatimit	132,577,595	93,788,736
<b>Rregullime për:</b>		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	103,073,742	81,259,790
Fitim nga kursi i këmbimit	79,363	-
Të ardhura nga interesat	(214,111)	(912,505)
Shpenzime per interesa	12,602,095	28,467,848
Shpenzime tatim fitimi	45,225,864	33,318,553
Humbje nga shitja e aktiveve fikse	1,031,494	-
Efektet e rivlerësimit tek paraaja dhe ekuivalentet e saj	2,620,547	786,508
<b>Fitimi nga aktiviteti operativ para ndryshimeve në kapitalin punues</b>	<b>296,996,589</b>	<b>236,708,930</b>
Rënie / (rritje) në inventar	917,200	(5,525,679)
(Rritje) / rënie në llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera	(353,235)	10,892,382
Rritje në llogaritë e pagueshme dhe të tjera	33,608,127	8,174,224
Interesi i paguar	(17,350,400)	(31,303,895)
Tatimi fitimi i paguar	(47,210,061)	(26,011,771)
<b>Paraaja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative</b>	<b>266,608,220</b>	<b>192,934,191</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Blerja e aktiveve afatgjata jomateriale	(48,418,856)	(68,175,461)
Interesa të arkëtuara	605,102	912,505
<b>Paraaja neto e përdorur në aktivitetet investuese</b>	<b>(47,813,754)</b>	<b>(67,262,956)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet e financimit</b>		
Shlyerje e huasë, neto	(200,000,000)	-
Dividenti i paguar	-	(59,789,153)
<b>Paraaja neto e përdorur në aktivitetet financuese</b>	<b>(200,000,000)</b>	<b>(59,789,153)</b>
<b>Rritja neto e parasë dhe ekuivalenteve të saj</b>	<b>18,794,466</b>	<b>65,882,082</b>
<b>Paraaja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit</b>	<b>358,614,776</b>	<b>293,519,210</b>
Efektet e ndryshimeve në kursin e këmbimit tek paraaja dhe ekuivalentet e saj	(2,620,547)	(786,508)
<b>Paraaja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit</b>	<b>374,788,695</b>	<b>358,614,776</b>

Pasqyra e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 deri në 28 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## **1. HYRJE**

SGS Automotive Albania sh.p.k. ("Shoqëria") është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e vendosur në Republikën e Shqipërisë dhe e regjistruar më 10 shtator 2009 në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Adresa e zyrave qendrore është në Tiranë, Rr. Irfan Tomini, Ndërtesa G & P, Kati i parë, Tiranë.

Shoqëria mëmë është SGS Societe General De Surveillance s.a., Gjenevë, Zvicër, e cila më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 zotëron 100% të kapitalit të nënshkruar të Shoqërisë.

Aktivitetet kryesore të Shoqërisë lidhen me inspektimin teknik të mjeteve automobilistike për një periudhë 10 vjeçare siç është rënë dakord në kontratën e koncensionit ndërmjet SGS Societe General De Surveillance s.a. dhe Ministrisë së Transportit dhe Punëve Publike të Shqipërisë, e cila ka rolin e autoritetit kontraktues. Shoqëria operon në tregun vendas dhe ka hapur 15 pika në të gjithë vendin.

Më 31 dhjetor 2015 Shoqëria ka 151 punonjës (31 dhjetor 2014: 140).

### **1.1 Marrëveshja e Koncesionit**

#### *Përshkrimi i marrëveshjes*

Sipas Nenit 100 te Kushtetutës dhe Nenit 21 të Ligjit Shqiptar nr. 9663 "Ligji i Koncesionit" (i ndryshuar) i datës 18 dhjetor 2006, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, i titulluar "Mbi aprovimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së koncesionit", i datës 19 janar 2007, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 643, të titulluar " Mbi zgjedhjen e Autoritetit Kontraktual për dhënien e koncesionit të kontrollit të detyrueshëm teknik për mjetet dhe rimorkiot e tyre në Republikën e Shqipërisë, për (i) projektimin, financimin, rehabilitimin, testimin, përdorimin dhe mbajtjen e qendrave të kontrollit teknik ekzistuese dhe makineritë dhe mjetet ekzistuese përgjatë periudhës së koncesionit; (ii) projektimin, financimin, ndërtimin, testimin, pronësinë, përdorimin dhe transferimin e projektit Qeverisë së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Transportit dhe Punëve Publike të Shqipërisë dhe SGS General De Surveillance s.a që ka hyrë në marrëveshjen e koncesionit më datë 3 shtator 2009 ("Marrëveshja e Koncesionit").

#### *Periudha e koncesionit*

Koncesioni është dhënë për një periudhë prej 10 vitesh që fillon nga data efektive (3 shtator 2009).

#### *Objekti i koncesionit:*

Dhënësi i grantit i jep Operatorit të drejtën të:

1. projektjohë, financjohë, rehabilitjohë, testjohë, mbajë dhe të përdorë QKT ekzistuese dhe makineritë dhe mjetet e saj për periudhën e koncesionit.
2. projektjohë, financjohë, ndërtojë, testjohë, mbajë dhe në fund të periudhës së koncesionit të transferojë QKT dhe mjetet dhe makineritë e saj tek autoriteti kontraktues.
3. që t'i ofrojë klientëve shërbimin e kontrollit të detyruar teknik për mjetet (makinat). Të ofrojë shërbim profesional në përputhje me marrëveshjen, manualin e kontrollit dhe ligjit në fuqi.

#### *Dorëzimi i koncesionarit QKT*

1. Në fund të periudhës së marrëveshjes Operatori duhet t'i kthejë QKT ekzistuese dhënësit të grantit.
2. Në fund të periudhës së marrëveshjes Operatori duhet t'i kthejë dhënësit të grantit QKT-në e sapo ndërtuar dhe makineritë dhe pajisjet e saj. Ky kthim nuk duhet te ndiqet nga asnjë pagesë e dhënësit të koncesionit përkundrejt operatorit.
3. Operatori duhet t'i transfrojë gjithashtu pajisjet elektronike dhe kompjuterike, ndërtimin në proces, marrëveshje licensimi mbi programe kompjuterike, të drejta kontraktuale, regjistrimet kontabël etj.



## **1. HYRJJE (VAZHDIM)**

### **1.1 Marrëveshja e Koncesionit (vazhdim)**

#### *Te drejtat e Koncesionarit*

- Të ushtrojë të gjitha të drejtat në lidhje me përdorimin ekskluziv të sheshit dhe të pajisjeve ekzistuese, dhe të pajisjeve elektromekanike dhe kompjuterike (nga data e instalimit).
- Të punësojë apo angazhojë punonjës me qëllim zbatimin e koncesionit si dhe të hartojë politikën e vet të punësimit në përputhje me ligjet në fuqi dhe këtë kontratë.
- Të kryejë veprime të tjera që i konsideron të nevojshme për të përmbushur detyrimet dhe të ushtrojë të drejtat e tij sipas kësaj kontrate.
- Të kërkojë zgjatjen e periudhës së koncesionit në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate.

#### *Detyrime të Përgjithshme të Koncesionarit*

- të zbatojë projektin e koncesionit në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate dhe anekset e saj.
- brenda 5 muajve, Koncesionari duhet të ketë përfunduar rehabilitimin e QKT-ve ekzistuese në përputhje me ligjin.
- brenda 6 muajve nga paisja me leje ndërtimi, Koncesionari duhet të ketë përfunduar së ndërtuari QKT-në e re.
- të ofrojë dhe të kryej shërbimin e kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në përputhje me ligjet, manualin e kontrollit të mjeteve, praktikat më të mira të industrisë dhe ofertën e koncesionarit dhe të mbajë të pacënuar ofrimin e këtij shërbimi.
- nga data efektive të zbatojë si orar minimal pune në QKT ekzistuese, QKT e Re (pas ndërtimit në përputhje me këtë kontratë) dhe QKTL, orarin e hënë – e premte 09:00-17:00 dhe e shtunë 08:00-13:00. Koncesionari gjatë këtij orari detyrohet të mbajë funksionale QKT ekzistuese, QKT e re (pas ndërtimit në përputhje me këtë kontratë) dhe QKTL. Ky orar mund të jetë objekt rishikimi me marrëveshje të shkruar mes palëve me ose pa njoftim paraprak nga pala e interesuar.
- të lejojë autoritetin kontraktues të inspektojë secilën nga QKT ekzistuese, QKT e Re dhe QKTL në çdo kohë të arsyeshme me ose pa njoftim paraprak.
- të kryejë kontrole teknike të gjitha mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre të paraqitura në testim në përputhje me manualin e kontrollit të mjeteve.
- të mirëmbajë QKT ekzistuese, QKT të Re dhe QKTL, pajisjet ekzistuese dhe pajisjet elektromekanike dhe kompjuterike deri në momentin e kthimit mbrapsht tek autoriteti kontraktues sipas kushteve të kësaj kontrate në përputhje me praktikat më të mira të industrisë.
- të përballojë vetë të gjitha kostot dhe shpenzimet e çdo natyre lidhur me largimin dhe transportimin nga sheshi i paisjeve ekzistuese në vendin e përcaktuar nga autoriteti kontraktues në përfundim të fazës së ndërtimit.
- të ruajë të gjitha vërtetimet e papërdorura apo të palëshuara për rezultatet e kontroleve të kryera në QKT ekzistuese, QKT e re dhe QKTL në një vend të sigurt nën kontrollin e koncesionarit dhe në kushte të përshtatshme për t'i ruajtur ato nga dëmtime të çdo lloji si psh mekanike, atmosferike, etj.
- t'i paraqesë autoritetit kontraktues në kohë të përshtatshme sapo t'i kërkohet prej tij informacion apo çdo dokument të kërkuar që ka të bëjë me funksionimin e QKT ekzistuese, QKT e re dhe QKTL si dhe të shërbimit.
- të shoqërojë çdo pagesë të tarifës koncesionare me një raport dhe dokumenta të nevojshëm plotësues mbi xhiron e realizuar nga tarifat e kontrollit dhe tarifat e rikontrollit për periudhën për të cilën pagesa e tarifës koncesionare kryhet.
- të krijojë një bazë të dhënash elektronike të re dhe bashkëkohore dhe ta përditësojë atë periodikisht. Specifikimet teknike për realizimin e këtij procesi do të përcaktohen nga ana e stafit teknik përkatës të të dy palëve.

## **1. HYRJE (VAZHDIM)**

### **1.1 Marrëveshja e Koncesionit (vazhdim)**

#### *Detyrime të Përgjithshme të Koncesionarit (vazhdim)*

- në fund të periudhës koncesionare të transferojë tek autoriteti kontraktues pronësinë mbi QKT e re, QKTL, linjat e kontrollit dhe pajisjet elektromekanike dhe kompjuterike në gjendje funksionale, përjashtuar amortizimin normal, ashtu siç do të jenë pas kryerjes së riinvestimit.
- të mos kryejë shërbimin ndaj mjeteve të cilat nuk kanë paguar detyrimet fiskale që lidhen me përdorimin e mjeteve të tilla si: taksa vjetore e qarkullimit rrugor, taksa vjetore e rregjistrimit të përvitshëm të mjeteve dhe gjobat për mosparaqitjen brenda afateve për kryerjen e shërbimit në qendrat e kontrollit teknik.
- brenda muajit të parë të vitit të 7-të kalendarik të periudhës koncesionare, Koncesionari duhet të paraqesë pranë autoritetit kontraktues, kalendarin e punimeve të riinvestimit, ku të jenë përcaktuar afatet e riinvestimit dhe vlerat përkatëse sipas zërave.

#### *Tarifat e koncesionit*

Koncesionari duhet t'i paguajë dhënësit të grantit një tarifë prej 5% të fitimit vjetor (para tatimit fitimit).

Tarifa e koncesionit do të llogaritet dhe paguhet çdo muaj duke filluar nga data efektive 3 shtator 2009.

#### *Investimet e operatorit*

Koncesionari duhet të bëjë një investim me qëllim që të bëjë të mundur ofrimin e shërbimit të kontrollit teknik. Investimi duhet të jetë 561,003,000 Lek nga të cilat 267,402,000 Lek duhen për pajisjet Elektro-mekanike dhe kompjuterat.

#### *Riinvestimet e Koncesionarit*

Koncesionari ka detyrimin ta mirëmbajë pronën nën koncesion. Koncesionari do të investojë në tre vitet e fundit të marrëveshjes një shumë prej 172,000,000 Lek e cila përbën 30.7% të investimit të operatorit.

Nëse Koncesionari nuk ka bërë riinvestimin e plotë përpara se marrëveshja e koncesionit të mbarojë, ai duhet ti paguajë diferencën dhënësit të grantit të koncesionit.

## **2 BAZAT E PËRGATITJES**

### **2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjes të specifikuar nga SNRF për secilin prej aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë përkrahur më poshtë në politikat kontabël.

### **2.2 Baza e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe paraqitur në monedhën vendase "Lek".

## **2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)**

### **2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve, pasigurive dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në pasqyrat financiare kontabël duke marrë parasysh natyrën e operacioneve që Shoqëria ka.

## **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL**

### **3.1 Standardet e reja dhe të rishikuara në fuqi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

Standardet e mëposhtme, të cilat janë kryesisht ndryshime të standardeve ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit janë efektive për periudhën aktuale:

- **Ndryshimet e SNK 19 “Përfitimet e punonjësve”** – Përcaktimi i planeve të përfitimit: Kontributet e Punonjësve (efektive për periudhat që fillojnë nga 1 korrik 2014),
- **Ndryshime në standardet e ndryshme “Përmirësimet e SNRF-ve (cikli 2010-2012)”** – Ndryshime që rezultojnë nga rishikimi vjetor që i është bërë SNRF-ve (SNRF 2, SNRF 3, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim që të shmangen mospërputhjet dhe të qartësohet formulimi i standartit (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë nga data 1 korrik 2014),
- **Ndryshime në standardet e ndryshme “Përmirësimet e SNRF-ve (cikli 2011-2013)”** - Ndryshime që rezultojnë nga rishikimi vjetor që u është bërë SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 13 dhe SNK 40), kryesisht me qëllim që të shmangen mospërputhjet dhe të qartësohet formulimi i standartit (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë nga data 1 korrik 2014).

Zbatimi i këtyre ndryshimeve tek standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndryshime materiale në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

### **3.2 Standarde dhe interpretime në publikim ende jo në fuqi**

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme janë publikuar, por ende nuk jo në fuqi:

- **SNRF 9 “Instrumentat financiare”** – (efektiv për periudhat që fillojnë nga 1 janar 2018).
- **SNRF 14 “Rregullimi i Llogarive të Shtyra”** - (efektiv duke filluar 1 janar 2016 e në vazhdim)

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.2 Standarde dhe interpretime në publikim ende jo në fuqi (vazhdim)**

- **SNRF 15 "Të ardhura nga Kontratat me Klientët"** dhe ndryshime të mëtejshme (efektiv duke filluar nga 1 janar 2018 e në vazhdim),
- **SNRF 16 "Qiratë"** (efektiv duke filluar nga 1 Janar 2019 e në vazhdim),
- **Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara" dhe SNK 28 "Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta"**- Shitja apo kontributi i pasurive ndërmjet një investitori dhe bashkëpunetori të tij ose sipërmarrje të përbashkët dhe ndryshime të mëtejshme (data efektive është shtyrë për një kohë të pacaktuar derisa projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit të përfundoj),
- **Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara" dhe SNRF 12 "Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera" dhe SNK 28 "Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta"** - Subjektet e investimeve: Përfshirja konsolidimi (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016),
- **Ndryshime në SNRF 11 "Marrëveshjet e përbashkëta"** - Kontabiliteti për blerjet e interesave në operacionet e përbashkëta (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016),
- **Ndryshime në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare"** - Iniciativat e zbulimit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2016),
- **Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e Fluksit të Parasë"** - Nisma Për Paraqitje (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2017),
- **Ndryshime në SNK 12 "Tatimet mbi të ardhurat"**, - Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për Humbjet e Parealizuara (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2017),
- **Ndryshime në SNK 16 "Prona, Makineri dhe Pajisje" dhe SNK 38 "Aktive jo-materiale"** - Sqarim i metodave të pranueshme të zhvleresimit dhe amortizimit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016),
- **Ndryshime në SNK 16 "Prona, Makineri dhe Pajisje" dhe SNK 41 "Agrobiznesi"** - Agrobiznes: Bimët bartëse (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016),
- **Ndryshime në SNK 27 "Pasqyrat financiare individuale"** - Metoda e kapitalit në pasqyrat financiare individuale (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016),
- **Ndryshime në disa standarde "Përmirësimet e SNRF-ve (2012-2014)"** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF-ve (SNRF 5, SNRF 7, SNRF13, SNK 19, SNK 34) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e fjalëve (ndryshimet duhet të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016).

Shoqëria ka vendosur të mos i zbatojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave të tyre efektive. Shoqëria beson se zbatimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën fillestare të zbatimit.

### 3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.3 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit njihen në fitim dhe humbje.

Zërat jo monetare që maten në bazë të kostos historike në monedhë të huaj (konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit), përveç zërave jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë të cilët konvertohen me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset zyrtare të këmbimit të Bankës së Shqipërisë janë si vijim:

	<b>31 dhjetor 2015</b>	<b>31 dhjetor 2014</b>
LEK / USD	125.79	115.23
LEK / EUR	137.28	140.14

#### 3.4 Aktivet afatgjata jomateriale

##### *Marrëveshje për shërbime koncesionare*

Shoqëria njih një aktiv afatgjatë jomaterial nga një marrëveshje shërbimi koncesionare në momentin kur i lind e drejta për përdorimin e infrastrukturës së koncesionit. Aktivet afatgjata jomateriale janë matur fillimisht me kosto e cila është vlera e drejtë e paguar për të ofruar shërbimet koncesionare të marrëveshjes koncesionare. Pas njohjes fillestare aktivet afatgjata jomateriale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e akumuluar nga zhvlerësimi.

Shoqëria ka aplikuar KNIRF 12 *Marrëveshjet për Shërbimet Koncesionare* efektive për periudhën vjetore më apo pas dates 1 janar 2008. Interpretimi është zbatuar për herë të parë në përgatitjen e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011 në përputhje me IAS 8 Politikat Kontabël. Në përputhje me KNIRF 12 *Marrëveshjet për Shërbimet Koncesionar*, aktivet afatgjata jomateriale përfaqësojnë të drejtën e Shoqërisë për të ofruar shërbime koncesionare në këmbim të shpërblimeve jo monetare të transferuara tek dhënësit të grantit.

Në përputhje me marrëveshjen ndërmjet Shoqërisë dhe dhënësit të grantit, aktivet afatgjata jomateriale përfshijnë elementë të shpërblimeve jomonetare në këmbim të shërbimeve koncesionare të ofruara:

##### *- Shpërblime jo-monetare (Qendra e Kontrollit Teknik dhe pajisje të lidhura me të)*

E drejta për të ofruar shërbime koncesionare në këmbim të përdorimit të Qendrave të Kontrollit Teknik ("QKT"), njihet në koston e investimit për projektim, financim, rehabilitim, testim, mirëmbajtje dhe përdorim të QKT-ve ekzistuese dhe pajisjeve të lidhura me të për të cilat konsiderohet si vlera e drejtë e tij.

##### *- Shpërblime jo-monetare (Qendra e Kontrollit Teknik dhe pajisje të lidhura me të)*

Vlera e riinvestimit në 3 vitet e fundit të aktivitetit, paraqet një përmirësim të detyrueshëm të infrastrukturës së shërbimit të koncesionit (zëvendëson infrastrukturën origjinale të programeve dhe pajisjeve kompjuterike) i cili rrit jetën e aktivitetit. Shpenzimet e përmirësimit (të skontuara me vlerën aktuale me një normë para tatimit që paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet për detyrimin specifik) matet si një aktiv afatgjatë jomaterial dhe njihet në fillim të periudhës së koncesionit dhe amortizohet gjatë gjithë periudhës së koncesionit.

##### *Shpenzimet vijuese*

Shpenzimet vijuese kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të përfshirë specifikisht në aktivin të cilit i përkasin. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në pasqyrat e të ardhurave përmbledhëse (në fitim ose humbje) kur ndodhin.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.4 Aktivet afatgjata jomateriale (vazhdim)**

##### *Amortizimi*

Jeta e dobishme e vlerës së mbetur të aktivit afatgjatë jomaterial që i përket marrëveshjes së shërbimit koncesionar është periudha që kur në dispozicion për përdorim deri në fund të periudhës së koncesionit, 3 shtator 2019.

#### **3.5 Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare**

Vlerat kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe tatimit të shtyrë, rishikohen në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit. Humbja nga zhvlerësimi njihet në qoftë se vlera e kontabël e aktivit e kalon vlerën e rikuperueshme të tij. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose njësisë gjeneruese të parasë së tij, tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Njësia gjeneruese e parasë është grupi më i vogël i identifikueshëm aktivesh që gjeneron rrjedhje parash që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në të ardhura dhe shpenzime. Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose një njësie gjeneruese të parasë, është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhja e pritshme e ardhshme e parasë është skontuar në vlerën aktuale duke përdorur normën e skontimit para tatimit që reflekton vlerën aktuale të parasë në treg dhe rreziqet specifike të aktivit.

Përsa i përket aktiveve të tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka tregues që humbja nga zhvlerësimi nuk ekziston më dhe ka patur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi, rimerret vetëm nëse vlera kontabël e aktivit nuk e kalon vlerën që do të ishte përcaktuar, neto me zhvlerësimin ose amortizimin, nëse humbja nga zhvlerësimi nuk do të ishte njohur.

#### **3.6 Instrumentat financiarë**

Shoqëria mban vetëm instrumente financiare jo-derivative që përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera, paraja dhe ekuivalentet e saj, huatë dhe llogari të pagueshme dhe të tjera. Instrumentat financiarë jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentat jo në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, duke i shtuar çdo kosto që lidhet drejtpërdrejtë me transaksionin. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivative maten si më poshtë.

Një aktiv financiar njihet nëse Shoqëria bëhet pjesë në kushtet kontraktuale të aktivit. Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë nga aktivet financiare skadojnë ose në qoftë se ajo transferon të drejtat për të arkëtuar flukset e parasë kontraktuale të aktivit financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivit financiar transferohen. Blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare regjistrohen në datën e tregtimit, data në të cilën Shoqëria angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivit. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të specifikuar në kontratë skadojnë, janë hequr ose anuluar.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.6 Instrumentat Financiare (vazhdim)**

##### *Paraja dhe ekuivalentet e saj*

Paraja dhe ekuivalentet e saj përbëhen nga paraja në arkë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë të cilat kanë maturitet tre muaj ose më pak, të cilat nuk janë subjekt i rreziqeve të rëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë, dhe përdoren nga Shoqëria për manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

##### *Llogari të arkëtueshme dhe të tjera*

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht njihen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi.

Provigjoni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme krijohet kur ka tregues objektiv që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve origjinale të llogarive të arkëtueshme.

Vështirësitë e konsiderueshme financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose të ndodhë një riorganizim financiar dhe mospagesat konsiderohen indikatorë që llogaritë e arkëtueshme janë zhvlerësuar.

Provigjoni është diferenca midis vlerës kontabël të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë, të skontuara me normën e interesit efektiv. Aktivitetet me maturitet afatshkurtër nuk skontojnë. Vlera kontabël e aktivitetit zvogëlohet përmes përdorimit të një llogarie provigjoni dhe shumata e humbjes njihet në fitim ose humbje. Kur një llogari e arkëtueshme është e parikuperueshme, vlera në pasqyrën e pozicionit financiar mbyllet kundrejt provigjionit për këtë llogari. Nëse shumata rikuperojnë më vonë, ato regjistrohen në fitim ose humbje.

##### *Huatë*

Pas njohjes fillestare, huatë që mbartin interes regjistrohen me kosto të amortizuar me çdo diferencë midis koston dhe vlerës së rimarrjes dhe njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës së huamarrjes mbi bazën e interesit efektiv.

##### *Llogaritë e pagueshme dhe të tjera*

Llogaritë e pagueshme fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe në vazhdimësi maten me koston e amortizuar.

##### *Njohja e zhvlerësimit të aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka tregues objektiv që tregon se një ose disa ngjarje kanë patur një ndikim negativ në flukset e ardhshme monetare të vlerësuara të aktivitetit financiar.

Një zhvlerësim në vlerë në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë të vlerësuara duke i skontuar me normën origjinale të interesit efektiv të aktivitetit. Aktivitetet financiare individualisht të rëndësishme testohen për zhvlerësim në bazë individuale. Aktivitetet e mbetura financiare vlerësohen në mënyrë kolektive në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi zhvlerësimi është njohur. Rimarrja njihet në fitim dhe humbje.

### **3.7 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë nga Shoqëria për shërbimet e kryera, duke përjashtuar taksat e shitjes dhe zbritjet.

## **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **3.7 Njohja e të ardhurave (vazhdim)**

Shoqëria zbaton kriteret e njohjes së të ardhurave të paraqitura si më poshtë për secilën pjesë të identifikueshme të transaksionit të shitjes, në mënyrë që të reflektojë përmbajtjen e transaksionit. Shpërblimi i marrë nga këto transaksione, është shpërndarë veçmas për secilën pjesë duke marrë në konsideratë vlerën relative të drejtë për secilën pjesë.

#### *Kryerja e shërbimeve*

E ardhura nga kryerja e shërbimeve njihet kur shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri, mbledhja është e mundshme dhe kostot që kanë ndodhur ose që do të ndodhin mund të maten në mënyrë të besueshme dhe kur kriteret për secilën nga aktivitetet e Shoqërisë janë plotësuar.

Këto kriteret specifike të njohjes së të ardhurave nga aktiviteti janë bazuar në shërbimin e ofruar konsumatorit dhe kushteve të kontratës në secilin rast. Bazuar në kontratën e koncesionit midis SGS Societe General De Surveillance s.a. dhe Ministrisë së Transportit dhe Punëve Publike, Shoqëria është e autorizuar të ofrojë shërbime inspektimi të mjeteve të transportit siç është përcaktuar në kontratën e koncesionit.

#### *Të ardhura nga interesat*

Të ardhurat nga interesat përlllogariten në bazë kohore, duke iu referuar principalit të papaguar dhe normës së interesit efektiv.

### **3.8 Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar përbëhet nga kontributet në para të themeluesve të Shoqërisë. Kapitali aksionar mbahet në monedhën vendase LEK, i konvertuar nga monedha e huaj, duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Kapitali aksionar i Shoqërisë është njohur me vlerën nominale.

### **3.9 Përfitimet e punonjësve**

#### *Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore*

Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet e detyrueshme të pensioneve sipas legjislacionit vendor. Këto kosto të kryera në emër të Shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin që ndodhin.

### **3.10 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyrë**

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital apo në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen e vitit, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% e të ardhurës së tatueshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke paraqitur diferencat e përkohshme midis vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i



shtyrë matet me normat tatimore që priten të zbatohen për diferencat e përkohshme kur ato rimerren, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhura të tatueshme të ardhshme do të realizohen kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.10 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyrë (vazhdim)**

Aktivitet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme të realizohen përfitime tatimore të lidhura me të. Sipas pasigurive të lidhura me realizimin e aktivitetit tatimor të shtyrë (të cilat vijnë nga diferencat e përkohshme të aktiveve për të cilat baza tatimore është më e madhe se vlera kontabël) të lidhura edhe me kohëzgjatjen e kontratës së koncesionit, Shoqëria nuk ka njohur aktivitet tatimor të shtyrë në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2015.

#### **3.11 Provigjonet**

Provigjonet njihen kur si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime (ligjore ose konstruktive) të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Nëse efekti është material, provigjonet janë përcaktuar duke ju zbritur vlerën e pritshme të flukseve të parasë të skontuara me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimeve. Provigjonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk është me e nevojshme që një dalje e mundshme burimesh që përfshin përfitime ekonomike për shlyerjen e detyrimit, provigjonet rimerren. Provigjonet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë njohur fillimisht. Nuk njihet provigjon për humbjet e ardhshme operative. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara nuk njihen.

#### **3.12 Angazhime dhe detyrime të ardhshme**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Për një detyrim të kushtëzuar jepet informacion shpjegues vetëm kur mundësia e një daljeje burimesh që përfshin përfitime ekonomike nuk ekziston më. Aktivitet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por jepet informacion shpjegues kur realizimi i të ardhurave është i mundur. Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provigjon nëse është e mundur që një ngjarje e ardhshme do ta konfirmojnë atë, një detyrim lind në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i humbjes.

#### **3.13 Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarët dhe drejtorët e Shoqërisë, së bashku me entitetet që kontrollojnë, që kanë një ndikim të rëndësishëm mbi veprimtarinë dhe drejtimin e Shoqërisë. Në marrjen në konsideratë të çdo marrëdhënie të mundshme me palët e lidhura, vëmendja i drejtohet thelbit të marrëdhënies, jo vetëm formës ligjore.

#### **3.14 Ngjarjet pas datës së raportimit**

Ngjarjet pas datës së raportimit që ofrojnë informacion shtesë në lidhje me pozicionin financiar të Shoqërisë në datën e raportimit (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së raportimit që nuk janë ngjarje rregulluese janë paraqitur në shënimet e pasqyrave financiare nëse janë materiale.

#### **3.15 Krahasueshmëria**

Për qëllimin e krahasueshmërisë, interesi i përllogaritur i huave me vlerë 1,386,964 LEK (2014: 6,765,374) është rriklassifikuar nga “Të pagueshme dhe të tjera” në “Hua”.

**4. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE**

Aktivitet afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë të përbëra si më poshtë:

	<b>Pajisje IT</b>	<b>Të tjera</b>	<b>Riinvestimi</b>	<b>Totali</b>
<b>Kosto</b>				
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2014</b>	<b>340,611,096</b>	<b>481,406,221</b>	<b>139,302,800</b>	<b>961,320,117</b>
Shtesa	14,160,140	4,044,078	32,301,600	<b>50,505,817</b>
Pakësime	-	(2,086,961)	-	<b>(2,086,961)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>354,771,236</b>	<b>483,363,338</b>	<b>171,604,400</b>	<b>1,009,738,973</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>				
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2014</b>	<b>156,677,744</b>	<b>226,246,117</b>	<b>14,487,915</b>	<b>397,411,775</b>
Amortizimi i vitit	40,302,716	55,135,425	8,075,400	<b>103,513,541</b>
Pakësime	-	(439,799)	-	<b>(439,799)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2014</b>	<b>196,980,460</b>	<b>280,941,743</b>	<b>22,563,315</b>	<b>500,485,517</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>				
<b>31 dhjetor 2014</b>	<b>183,933,352</b>	<b>255,160,104</b>	<b>124,814,885</b>	<b>563,908,342</b>
<b>31 dhjetor 2015</b>	<b>157,790,776</b>	<b>202,421,595</b>	<b>149,041,085</b>	<b>509,253,456</b>

Gjatë 2015, Shoqëria ka blerë një program kompjuterik, i cili është përfshirë në aktive jomateriale në proces sepse është ende në fazën e implemetimit dhe nuk është llogaritur shpenzim amortizimi për vitin.

Në kategorinë “Të Tjera” janë përfshirë përmirësime të ndryshme teknike, elektrike për ndërtesat, pajisje dhe mobilje të ndryshme si dhe të gjitha aktivitet e tjera koncesionare që nuk përfaqësojnë pajisje IT.

**5. INVENTARI**

Inventari më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 mund të përmbledhet si më poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>Më 31 dhjetor 2014</b>
Materiale ndihmëse dhe të konsumueshme	3,001,818	462,118
Certifikata inspektimi dhe të tjera	3,559,343	7,016,244
<b>TOTALI</b>	<b>6,561,161</b>	<b>7,478,362</b>

**SGS Automotive Albania sh.p.k.**

**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

*(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku përcaktohet ndryshe)*

---

**6. LOGARITË E ARKËTUESHME DHE TË TJERA**

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera më 31 dhjetor 2015 and 31 dhjetor 2014 janë të detajuara si më poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>Më 31 dhjetor 2014</b>
<b>Llogaritë e arkëtueshme</b>		
Klientë vendas	1,111,203	168,508
Të arkëtueshme nga shoqëritë e sigurimit	947,979	1,109,781
<b>Totali i llogarive të arkëtueshme</b>	<b>2,059,182</b>	<b>1,278,289</b>
<b>Të tjera llogari të arkëtueshme</b>		
TVSH e arkëtueshme	45,822	37,036
Garanci të dhëna	223,784	223,784
Parapagimet	401,569	737,510
Shpenzime të periudhave të ardhshme	13,377,803	4,458,469
Të arkëtueshme nga personeli	269,006	369,508
<b>Totali i llogarive të tjera të arkëtueshme</b>	<b>14,317,984</b>	<b>5,826,307</b>
<b>Totali i llogarive të arkëtueshme dhe të tjera</b>	<b>16,377,166</b>	<b>7,104,596</b>

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera përbëhen nga klientët vendas, parapagimet e bëra për ndërtimet në vendet e inspektimit dhe garanci të dhëna për qira makinash në vitin 2013.

Shpenzimet e shtyra të përbëhen kryesisht nga shpenzimet e shtyra të sigurimeve nga kontrata e nënshkruar me Sigal në dhjetor të vitit 2015 për shërbimet e sigurimit për vitin 2016 dhe shpenzimet e kalibrimin të Maha, kontratë e cila u ndërpre pjesërisht gjatë vitit 2014, gjë që kontribuoi në rënie të gjendjes gjatë vitit 2014.

**7. PARAJA DHE EKVIVALENTET E SAJ**

Paraj dhe ekuivalentet e saj më 31 dhjetor 2015 and 2014 janë si më poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>Më 31 dhjetor 2014</b>
Llogaritë në banka në LEK	297,437,690	81,842,581
Depozitë bankare në LEK	71,589,456	271,375,745
Llogaritë në banka në monedhë të huaj	2,607,732	2,870,796
Arka në Lek	3,140,862	2,525,042
Arka në monedhë të huaj	12,955	612
<b>TOTALI</b>	<b>374,788,695</b>	<b>358,614,776</b>

**8. KAPITALI AKSIONAR**

Më 31 dhjetor 2015 kapitali aksionar ka qënë 190,000,100 LEK (2014: 190,000,100 LEK) dhe përfshin 1,900,001 aksione (2014: 1,900,001 aksione) me vlerë nominale 100 LEK për aksion, të zotëruara tërësisht nga SGS SOCIÉTÉ GÉNÉRALE DE SURVEILLANCE S.A.

**9. HUATË AFATSHKURTRA**

Huatë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 mund të përmblihen si më poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>Më 31 dhjetor 2014</b>
SGS SA, Geneva	226,448,000	426,448,012
Interesi i përllogaritur	<u>1,386,964</u>	<u>6,765,374</u>
<b>TOTALI</b>	<b><u>227,834,964</u></b>	<b><u>433,213,386</u></b>

Të gjitha huatë janë të marra nga Shoqëria mëmë dhe janë të pasiguruara. Huatë janë në LEK dhe mbartin interes. Interesi i huave për vitin 2015 lëviz ndërmjet 4.61% dhe 4.22%. Huatë maturohen më 7 nëntor 2016. Ne korrik të 2015 është shlyer njëra nga huatë e mbartura nga viti 2014 në vlerën nominale prej 200,000,000 LEK.

Megjithatë, meqenëse marrëveshja i jep të drejtën Shoqërisë që në mënyrë të njëanshme të ndërpresë marrëveshjen, në tërësi ose pjesërisht me jo më pak se 30 ditë njoftim paraprak ndaj huadhënësit, huatë janë klasifikuar si afatshkurtra.

**10. LLOGARITË E PAGUESHME DHE TË TJERA**

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 janë të detajuara si më poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>Më 31 dhjetor 2014</b>
<b>Llogaritë e pagueshme</b>		
- Furitorë të huaj	7,107,123	1,226,968
- Furnitorë vendas	<u>33,443,714</u>	<u>6,460,775</u>
<b>Totali i llogarive të pagueshme</b>	<b><u>40,550,837</u></b>	<b><u>7,687,743</u></b>
<b>Të tjera të pagueshme</b>		
Të tjera të pagueshme	18,283,150	20,738,784
TVSH të pagueshme	18,863,881	19,231,482
Të pagueshme ndaj punonjësve	9,898,305	14,728,076
Shpenzime të përllogaritura	<u>3,430,742</u>	<u>7,297,080</u>
<b>Totali llogarive të tjera të pagueshme</b>	<b><u>50,476,078</u></b>	<b><u>61,995,422</u></b>
<b>TOTALI</b>	<b><u>91,026,915</u></b>	<b><u>69,683,165</u></b>

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera të pagueshme janë të përbëra nga të pagueshme ndaj punonjësve, të pagueshme ndaj shtetit për sigurime shoqërore dhe tatimi mbi të ardhurat personale, tatim fitimi për t'u paguar dhe të pagueshme të tjera.

**11. VLERA E RIINVESTIMIT**

Detyrimi aktual për të riinvestuar 30.7% të investimit total është njohur si një detyrim afatgjatë, meqenëse daljet e burimeve që përfaqësojnë përfitime ekonomike, do të nevojiten për të mbyllur detyrimin në tre vitet e fundit të periudhës së marrëveshjes.

Shoqëria ka vlerësuar vlerën aktuale të detyrimit të riinvestimit më 31 dhjetor 2015 në 171,604,400 LEK.

**12. TË ARDHURAT**

Të ardhurat më 31 dhjetor 2015 janë të përbëra si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</b>
Tarifa për inspektimin e automjeteve	804,927,643	740,099,264
<b>TOTALI</b>	<b>804,927,643</b>	<b>740,099,264</b>

Shuma e deklaruar në FDP për qarkullimin total është 807,858,475 LEK, sipas zërave të mëposhtëm:

Shitje e shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve	806,177,313 LEK
Shitje Aktivi	1,681,162 LEK

Nga shitja e shërbimit, Shoqëria ka njohur si të ardhura të shtyra vlerën 1,383,720 LEK e cila është vlerë e lidhur me shërbimet e faturuara dhe të likuiduara por që nuk u janë ofruar klientëve brenda vitit ushtrimor. Ndërkohë nga të ardhurat e shtyra të vitit 2014, kanë kaluar në të ardhura të periudhës 134,050 LEK si teste të kryera në 2015. Këtë vlerë ndodhet e klasifikuar në zërin “Parapagime të marra” në detyrimet e Shoqërisë për vitin ushtrimor.

**13. MATERIALE TË PËRDORURA PËR KONSUM**

Materialet e përdorura për konsum më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë :

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</b>
Energji elektrike, ujë dhe karburant	7,702,799	7,747,776
Materiale ndihmëse dhe të konsumueshme nga shërbimet	6,023,727	6,524,451
Të tjera	912,361	1,862,400
<b>TOTALI</b>	<b>14,638,887</b>	<b>16,134,627</b>

**14. SHPENZIME PERSONELI**

Shpenzimet e personelit më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë të përbëra si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</b>
Pagat bruto	171,323,537	162,584,386
Sigurimet shoqërore	23,168,835	21,240,126
Përlllogaritje për bonuset	1,494,514	1,344,932
Përlllogaritje për pushimet	177,355	1,337,256
Të tjera	5,669,676	1,602,033
<b>TOTALI</b>	<b>201,833,917</b>	<b>188,108,733</b>

**15. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE**

Shpenzimet e tjera operative janë të detajuara si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</b>
Liçensa dhe të drejta të tjera	73,718,482	61,300,614
Shpenzime marketingu dhe promovimi	67,001,902	61,157,428
Shërbime sigure dhe shpenzime të tjera të ngjashme	49,125,876	57,250,442
Tarifa e koncesionit	40,309,078	37,084,738
Mirëmbajtja	30,447,178	42,153,355
Qira	11,515,512	10,219,331
Shpenzime transporti	7,074,250	6,153,495
Taksa dhe tarifa	4,637,654	5,822,891
Sigurime	4,406,410	3,968,889
Pajisje për zyra	2,751,258	2,825,069
Shpenzime telekomunikacioni	2,152,817	2,049,196
Shpenzime dietash dhe udhëtime	2,079,165	1,727,753
Shpenzime të tjera	1,300,843	1,371,805
Humbje nga shitja e aktivitet	1,031,496	-
Komisione bankare	687,601	815,771
Shpenzime pritje përcjellje, dhurata	537,961	907,131
Penalitete	21,904	6,648,200
<b>TOTALI</b>	<b>298,799,387</b>	<b>301,456,108</b>

**16. HUMBJE FINANCIARE, NETO**

Shpenzimet dhe të ardhurat financiare detajohen si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</b>
<b>Të ardhura financiare</b>		
Të ardhurat nga kursi i këmbimit	137,157	13,056
<b>Totali i të ardhurave financiare</b>	<b>137,157</b>	<b>13,056</b>
<b>Shpenzime financiare</b>		
Shpenzime interesi	(12,602,095)	(28,467,848)
Humbje nga kursi i këmbimit	(188,581)	(227,161)
Shpenzime të tjera financiare	3,875,268	2,649,236
<b>Totali i shpenzimeve financiare</b>	<b>(8,915,408)</b>	<b>(26,045,773)</b>
<b>Humbje financiare, neto</b>	<b>(8,778,251)</b>	<b>(26,032,717)</b>



## 17. TATIMI MBI FITIMIN

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Norma efektive e tatim fitimit %	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Norma efektive e tatim fitimit %
Fitimi para tatimit	177,803,459	100%	127,107,289	100%
Tatim fitimi sipas normës së aplikueshme të tatim fitimit	26,670,519	15%	19,066,093	15%
Shpenzimet e pazbritshme	18,555,345	11%	14,252,460	11%
<b>Shpenzim tatim fitimi (15%)</b>	<b>45,225,864</b>	<b>26%</b>	<b>33,318,553</b>	<b>26%</b>

Lista e detajuar e shpenzimeve të pazbritshme fiskalisht:

**Shpenzimet e pazbritshme per efekt fiskal 2015**

a- Gjoba	21,904
b-Shpenzime për personelin	4,869,238
c- Shpenzime të tjera	61,369,603
d-Amortizime	57,091,997
f –Dhurata	349,561
	-
<b>Totali i shpenzimeve të pazbritshme</b>	<b>123,702,303</b>

Shoqëria është subjekt i taksës mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e tatimit është 15% për 2015 (2014: 15%). Formularët e deklarimit të taksave dorëzohen çdo vit. Ligjet shqiptare dhe rregullat e tatimit janë subjekt i interpretimit nga autoritetet tatimore.

## 18. ANGAZHIME DHE PASIGURI

*Angazhimet*

Nuk ka zotime të rëndësishme kapitale të kontraktuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, që nuk janë njohur tashmë në pasqyrat financiare.

*Detyrimet e taksave*

Për vitet 2009 - 2013, regjistrimet dhe librat tatimore të Shoqërisë janë inspektuar nga autoritetet tatimore vendase. Sipas raportit tatimor dhe totalit të detyrimeve, gjobave dhe interesave për detyrimet e vendosura nga autoritetet tatimore, Shoqëria i ka paguar detyrimet përkatëse dhe i ka kaluar në pasqyrat e fitim-humbjes, përveç detyrimit të TVSH-së që lidhet me shërbimet e marra nga furnitorë jo-rezident, për të cilët shumat e paguara janë rregjistruar si aktiv, duke u bazuar në probabilitetin e lartë për të fituar apelimin sipas këshillimit të konsulentit ligjor.

*Çështje Gjyqësore*

Shoqëria nuk ka çështje të tjera gjyqësore përveç rasteve me ish-punonjësit që lidhen me ndërprerjen e kontratës së punësimit. Drejtimi beson që rezultati i ardhshëm i këtyre padive nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm në performancën financiare dhe aktivitetet e Shoqërisë.

**19. TRANKSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA**

	Llogari të arkëtueshme	Llogari të pagueshme	Të ardhurat	Kostot
<b>Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>				
SGS Ireland	-	4,237,834	-	4,756,201
SGS Albania	-	-	-	-
SGS Italy	-	-	-	109,824
SGS Group Management	888,535	208,803	888,535	79,317,133
SGS Greece	-	-	-	-
SGS SA Geneva (Huatë)	-	227,834,964	-	12,602,095
Kompensimi i drejtuesve kryesor	-	-	-	14,072,443
<b>TOTALI</b>	<b>888,535</b>	<b>232,281,601</b>	<b>888,535</b>	<b>110,857,696</b>
<b>Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</b>				
SGS Ireland	-	824,023	-	1,280,002
SGS Albania	-	-	3,267	797,791
SGS SA Geneva	-	-	-	2,766,389
SGS Group Management	-	-	-	63,963,949
SGS Greece	-	-	-	108,598
SGS SA Geneva	-	433,213,386	-	28,467,848
Kompensimi i drejtuesve kryesor	-	-	-	11,297,645
<b>TOTALI</b>	<b>-</b>	<b>434,037,409</b>	<b>3,267</b>	<b>108,682,222</b>

**20. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT**

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit, të cilat mund të kërkojnë rregullim ose prezantim në pasqyrat financiare.

## 21. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

### 21.1 Faktorët e rrezikut financiar

Aktiviteti i Shoqërisë e ekspozon atë ndaj disa rreziqesh financiare, duke përfshirë rrezikun e kredisë, rrezikun nga kurset e këmbimit dhe rrezikun e normave të interesit. Administrimi i rrezikut të Shoqërisë përqëndrohet në paparashikueshmërinë e tregut dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative mbi performancën e biznesit të Shoqërisë.

Administrimi i rrezikut bëhet nga drejtimi duke u bazuar në disa politika e procedura të shkruara dhe të aprovuara, të cilat mbulojnë të gjithë administrimin e rrezikut dhe pjesë specifike si rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normave të interesi, rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit.

### 21.2 Rreziku i tregut

#### Rreziku nga kurset e këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që vjen prej ekspozimit ndaj monedhave të huaja, kryesisht ndaj monedhës së Euros. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument për t'u mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit. Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur një pozicion të përshtatshëm neto në çdo monedhë dhe në total si dhe të monitorojë operacionet me bazë ditore.

Vlera e mbartur e aktiveve dhe detyrimeve të Shoqërisë në monedhë të huaj është si më poshtë:

		<b>2015</b>	<b>2014</b>
		<b>Në Lek</b>	<b>Në Lek</b>
<b>Aktivitet Financiare</b>			
Paraja dhe ekuivalentet e saj	EURO	2,620,688	2,871,408
Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera	EURO	906,610	-
		<b>3,527,298</b>	<b>2,871,408</b>
<b>Detyrimet Financiare</b>			
Llogaritë e pagueshme	EURO	(7,107,123)	(1,226,968)
Huatë	EURO	-	-
		<b>(7,107,123)</b>	<b>(1,226,968)</b>

#### Analiza e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

##### 31 dhjetor 2015

		<b>Fitim ose humbje</b>	
	<b>Vlera e ekspozimit, neto</b>	<b>+10%</b>	<b>-10%</b>
EURO	(3,579,825)	(357,983)	357,983

##### 31 dhjetor 2014

		<b>Fitim ose humbje</b>	
	<b>Vlera e ekspozimit, neto</b>	<b>+10%</b>	<b>-10%</b>
EURO	1,644,440	164,444	(164,444)

Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm mjetet monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të vitit dhe një korrigjim i vlerave të tyre është bërë për shkak të një ndryshimi me 10% të kurseve të këmbimit. Vlera pozitive/negative tregon rritje/ulje në fitim ose elemente të tjerë të kapitalit, gjë që ndodh kur monedha LEK dobësohet/forcohet në krahasim me monedhat e tjera të huaja me +/- 10%.

**21. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****21.2 Rreziku i tregut (vazhdim)**

*Fluksi i mjeteve monetare dhe rreziku i normave të interesit me vlerë të drejtë*

Shoqëria është e ekspozuar ndaj efekteve të luhatjeve të normave të interesit të tregut në pozicionin e saj financiar dhe rrjedhjet e mjeteve monetare. Drejtimi i Shoqërisë është kryesisht përgjegjës për monitorimin e përditshëm të rrezikut të normës neto të interesit dhe vendos limite për të pakësuar mundësinë që normat e interesit të mos përputhen. Nuk ka përqëndrim të interesit – fonde të marra hua nga institucione financiare ose njësi ekonomike me normë interesi të ndryshueshme në datat e raportimit. Luhatjet në normën e interesit të tregut sipas të cilave fondet merren hua, mund të kenë një efekt negativ në performancën financiare të Shoqërisë. Në të njëjtën kohë, Shoqëria nuk ka vendosur në mënyrë të rëndësishme aktivet e saj në depozita me afat dhe letra me vlerë shumë likuide, duke përfituar të ardhur shtesë nga interesi.

	<b>2015</b>	<b>2014</b>
<b>Aktive financiare</b>		
<i>Pa interes:</i>		
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	1,380,209	538,016
Paraja dhe ekuivalentet e saj	374,788,695	358,614,776
	<u><b>376,168,904</b></u>	<u><b>359,152,792</b></u>
<b>Detyrime financiare</b>		
<i>Pa interes:</i>		
Llogari të pagueshme dhe të tjera	72,163,034	50,451,687
<i>Me normë fikse interesi:</i>		
Huatë	226,448,000	426,448,012
	<u><b>298,611,034</b></u>	<u><b>476,899,699</b></u>

Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit meqenëse nuk ka detyrime me norma të luhatshme interesi.

**21.3 Rreziku i kredisë**

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjeve financiare për Shoqërinë nëse një klient ose palë tjetër nuk përmbush detyrimet kontraktuale dhe vjen kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë është ndikuar kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient.

Shoqëria ka vendosur politika për t'u siguruar që shërbimet të ofrohen pas një parapagimi nga klientët. Kjo politikë kufizon shumën e ekspozimit ndaj një pale tjetër. Ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë përfaqësohet nga vlera kontabël e çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar.

**21. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**21.3 Rreziku i kredisë (vazhdim)**

Shoqëria krijon një provigjon për zhvlerësimin që përfaqëson vlerësimin e humbjeve nga llogaritë e arkëtueshme duke u bazuar në humbje specifike të lidhura me ekspozime të rëndësishme individuale. Ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë përfaqësohet nga vlera kontabël e çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar si më poshtë:

	2015	2014
<b>Klasat e aktiveve financiare – vlerat kontabël:</b>		
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	1,380,209	538,016
Paraja dhe ekuivalentet e saj	374,788,695	358,614,776
	<b>376,168,904</b>	<b>359,152,792</b>

Rreziku i kredisë për mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre konsiderohet i papërfillshëm, meqenëse palët respektive janë banka me reputacion të mirë dhe me një cilësi të lartë të vlerësimit të rrezikut të kredisë.

Sipas pasqyrës së pozicionit financiar cilësia e kredisë për llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë përmbledhet në Shënimin 6.

**21.4 Rreziku i likuiditetit**

Shoqëria i drejton nevojat e saj për likuiditet duke monitoruar me kujdes pagesat e huave të skeduluara dhe duke parashikuar hyrjet dhe daljet e parave bazuar në rrjedhën e përditshme të biznesit. Nevojat për likuiditet monitorohen në grupime të ndryshme kohore. Nevojat neto për mjete monetare në arkë krahasohen me mjetet e disponueshme të huamarrjes në mënyrë që të përcaktohet çdo humbje. Kjo analizë tregon nëse mjetet e disponueshme të huamarrjes janë të mjaftueshme për periudhën në shqyrtim. Shoqëria mban para në arkë dhe bankë për të përmbushur nevojat e saj për likuiditet për një periudhë minimale prej 30 ditësh.

Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, detyrimet financiare të Shoqërisë kanë maturime kontraktuale si më poshtë:

Më 31 dhjetor 2015	Afatshkurtra		Afatgjata
	1 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet
Paraja dhe ekuivalentet e saj	374,788,695	-	-
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	16,377,166	-	-
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>391,165,861</b>	-	-
Huatë	226,448,000	-	-
Llogari të pagueshme dhe të tjera	72,163,034	-	-
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>298,611,034</b>	-	-
<b>Hendeku i maturitetit neto</b>	<b>92,554,827</b>	-	-

**21. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****21.4 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Më 31 dhjetor 2014	Afatshkurtra		Afatgjata
	1 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet
Paraja dhe ekuivalentet e saj	374,788,695	-	-
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	7,104,596	-	-
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>381,893,291</b>	-	-
Huatë	426,448,012	-	-
Llogari të pagueshme dhe të tjera	50,451,687	-	-
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>476,899,699</b>	-	-
<b>Hendeku i maturitetit neto</b>	<b>(95,006,408)</b>	-	-

Shumat e mësipërme reflektojnë rrjedhjet kontraktuale të parasë, të cilat mund të ndryshojnë nga vlerat kontabël të detyrimeve në datën e raportimit.

**21.5 Rreziku i manaxhimit të kapitalit**

Objektivat e Shoqërisë në manaxhimin e kapitalit janë të ruajë vazhdimësinë e Shoqërisë për të siguruar kthime për aksionarët dhe përfitime për palët e tjera si dhe të mbajë një strukturë optimale kapitali për të pakësuar kostot e kapitalit. Për të ruajtur ose përshtatur strukturën e kapitalit, Shoqëria mund të përshtasë sasinë e dividendëve të paguar, të bëjë shtesa në kapitalin e nënshkruar dhe të paguar, ose të shesë aktive për të pakësuar borxhin.

*Raporti i huasë me kapitalin*

Struktura e kapitalit të Shoqërisë përbëhet nga huatë dhe kapitali, i cili përbëhet nga kapitali aksionar dhe fitimet e pashpëndara. Manaxhimi e rishikon strukturën e kapitalit në baza vjetore si një lidhje midis huave dhe kapitalit në total. Shoqëria financohet nëpërmjet borxhit nga Shoqëria mëmë siç tregohet në indikatorin e borxhit në fund të vitit:

	2015	2014
Huatë	226,448,000	426,448,012
Kapitali	322,577,595	284,198,778
	<b>0.70</b>	<b>1.50</b>

**21.6 Vlerësimi i vlerë së drejtë**

Vlera e drejtë përfaqëson çmimin që do të merret për të shitur një aktiv ose çmimin që do të paguhet për të transferuar një detyrim në një transaksion normal ndërmjet pjesëmarrësve në treg në datën e matjes.

**21. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****21.7 Instrumentet financiare të matura me vlerën e tyre të drejtë**

Aktivitetet financiare të matura me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar janë në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë e cila grupon aktivitetet dhe detyrimet financiare në tre nivele bazuar në rëndësinë e të dhënave të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të aktiveve financiare. Hierarkia e vlerës së drejtë është si vijon :

- **Niveli 1:** çmimet e kuotuar (jo të rregulluara) në tregjet aktive për aktive ose detyrime të njëjta;
- **Niveli 2:** të dhëna të tjera, përveç çmimeve të kuotuar, të përfshira në Nivelin 1, të cilat janë të mundshme për vëzhgimin e aktiveve dhe detyrimeve, në mënyrë të drejtpërdrejtë (p.sh. si çmime), ose jo të drejtpërdrejtë (p.sh. të përbëra nga çmimet) dhe;
- **Niveli 3:** të dhëna për aktivin ose detyrimin të cilat nuk janë të bazuara në të dhëna të disponueshme për mbikqyrjen e tregut.

Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë është përcaktuar duke përdorur të dhënat e nivelit të 2 dhe nuk ka riklasifikime ndërmjet niveleve të vlerës së drejtë.

**21.8 Instrumentet financiare që nuk paraqiten me vlerën e tyre të drejtë**

Tabela e mëposhtme përmbledh vlerat kontabël dhe vlerat e drejta për ato aktive dhe detyrime financiare të cilat nuk shfaqen në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e tyre të drejtë.

	Vlera kontabël		Vlera e drejtë	
	2015	2014	2015	2014
<b>Aktivitetet financiare</b>				
Paraja dhe ekuivalentet e saj	374,788,695	358,614,776	374,788,695	358,614,776
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	1,380,209	538,016	1,380,209	538,016
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>376,168,904</b>	<b>359,152,792</b>	<b>376,168,904</b>	<b>359,152,792</b>
<b>Detyrimet financiare</b>				
Huatë	226,448,000	426,448,012	226,448,000	426,448,012
Llogari të pagueshme dhe të tjera	72,163,034	50,451,687	74,776,774	50,451,687
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>298,611,034</b>	<b>476,899,699</b>	<b>301,224,774</b>	<b>476,899,699</b>

*Llogari të arkëtueshme dhe të tjera*

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera mbarten me koston e tyre të amortizuar, duke i zbritur provigjonet për zhvlerësim. Vlera e tyre e drejtë është e njëjtë me vlerën e tyre të mbartur për shkak të afatit të tyre të shkurtër të maturimit.

*Paraja dhe ekuivalentet e saj*

Vlera e drejtë e aktiveve monetare që përfshin mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, konsiderohet të jetë përafërsisht sa vlera e tyre përkatëse kontabël, për shkak të maturimit prej më pak se 3 muaj.

*Llogari të pagueshme dhe të tjera*

Vlera kontabël e furnitorëve dhe huave është përafërsisht sa vlera e tyre e drejtë për shkak të afatit të tyre të shkurtër të maturimit.

## 21. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

## 21.8 Instrumentet financiare që nuk paraqiten me vlerën e tyre të drejtë (vazhdim)

Vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë ndahen si më poshtë:

31 dhjetor 2015	Hua dhe të arkëtueshme	Akive me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	Të disponueshme për shitje	Totali
<b>Aktivet sipas pasqyrës së pozicionit financiar</b>				
Klientë dhe të arkëtueshme të tjera	1,380,209	-	-	1,380,209
Paraja dhe ekuivalentet e saj	374,788,695	-	-	374,788,695
	<b>376,168,904</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>376,168,904</b>
			<b>Detyrime të tjera financiare</b>	<b>Totali</b>
<b>Detyrimet sipas pasqyrës së pozicionit financiar</b>				
Huatë		-	226,448,000	226,448,000
Furnitorë dhe të pagueshme të tjera		-	72,163,034	72,163,034
		<b>-</b>	<b>298,611,034</b>	<b>298,611,034</b>
31 dhjetor 2014	Hua dhe të arkëtueshme	Akive me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	Të disponueshme për shitje	Totali
<b>Aktivet sipas pasqyrës së pozicionit financiar</b>				
Klientë dhe të arkëtueshme të tjera	538,016	-	-	538,016
Paraja dhe ekuivalentet e saj	358,614,776	-	-	358,614,776
	<b>359,152,792</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>359,152,792</b>
			<b>Detyrime të tjera financiare</b>	<b>Totali</b>
<b>Detyrimet sipas pasqyrës së pozicionit financiar</b>				
Huatë		-	426,448,012	426,448,012
Furnitorë dhe të pagueshme të tjera		-	50,451,687	50,451,687
		<b>-</b>	<b>476,899,699</b>	<b>476,899,699</b>